



Udhëzuesi i Udhëheqësit

MBËSHTETJA TE VETJA

PARATHËNIE

Ka nevoja të mëdha midis nesh. Shumë njerëz nuk janë të mbështetur te vetja dhe u mungon aftësia “për të siguruar nevojat shpirtërore dhe fizike të jetës për veten dhe familjen”¹. Presidenti Tomas S. Monson ka dhënë mësim: “Mbështetja te vetja është një element thelbësor për mirëqenien tonë shpirtërore si edhe materiale. . . . ‘Le të jemi të mbështetur te vetja dhe të pavarur. Shpëtimi nuk mund të sigurohet me ndonjë parim tjetër.’”²

Ata që kanë nevojë të mbështeten më shumë te vetja, mund të përfshijnë personat që marrin ndihmë nga ofertat e agjërimit, misionarët e kthyer, të sapokthyerit në besim, anëtarët më pak aktivë dhe udhëheqësit vendorë të priftërisë që kanë nevojë për punë më të mirë. Njëpërmjet Kishës së Tij, Zoti tani po siguron mjete, burime dhe procese të reja të fuqishme të përshkruara në këtë udhëzues për t’i ndihmuar anëtarët në shtegun e tyre drejt mbështetjes te vetja.³

Si udhëheqës priftërie, ju jeni një prej atyre të cilëve Zoti u ka thënë: “Jua kam dhënë . . . çelësat . . . për punën e shërbesës dhe të përsosjes së shenjtorëve të mi” (DeB 124:143) dhe “Ai të cilit i jepen këta çelësa, nuk ka asnjë vështirësi në marrjen e një diturie për fakte në lidhje me shpëtimin e fëmijëve të njerëzve” (DeB 128:11). Lexojeni pjesën “Shëmbëlltira e Shoferit të Autobusit” në të djathtë. Ju lutemi, përsiateni me kujdes rolin tuaj për çuarjen përpara të kësaj nisme thelbësore.

Ky udhëzues i udhëheqësit është hartuar që t’ju vijë në ndihmë ndërsa i ushtroni çelësat tuaj, i vini në praktikë këto mjete të reja dhe i ndihmoni anëtarët të ndihmojnë veten drejt mbështetjes te vetja. Teksa e bëni këtë, Fryma e Shenjtë do t’ju udhërrëfjë dhe Zoti do të bëjë që ju të jeni vegla e Tij për ngritjen e të varfërve e nevojtarëve dhe për përshpejtimin e punës së Tij për shpëtim.

1. *Manuali 2: Administrimi i Kishës* (2010), 6.1.1.

2. Thomas S. Monson (citon Marion G. Romnin), “Guiding Principles of Personal and Family Welfare”, *Ensign*, shtator 1986, f. 3

3. Për më shumë informacion, shihni srs.lds.org.

Botuar nga Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme
Solt-Lejk-Siti, Juta

© 2014, 2015 nga Intellectual Reserve, Inc.

I rezervohen të gjitha të drejtat.

Miratur për anglisht: 6/15

Miratur për përkthim: 6/15

Përkthim i *Leader Guide*

Albanian

12373 101

Shëmbëlltira e Shoferit të Autobusit

“Nisma për mbështetjen te vetja është si një autobus të cilit i duhet një shofer me patentë.

Autobusi është ndër-tuar nga trupa organizative e Shërbimeve për Mbështetjen te Vetja. Ai jepet nëpërmjet qendrës burimore të mbështetjes te vetja dhe komiteti i kunjit për mbështetjen te vetja merret me mirëmbajtjen. Specialistët e kunjit për mbështetjen te vetja dhe ndërmjetësit e grupi i ndihmojnë anëtarët të hipin në autobus (por ata duhet të hipin vetë në autobus). Presidenti i kunjit dhe peshkopët janë shoferët e autobusit.

Të gjithë duhet të bëjnë pjesën e tyre për t’i ndihmuar anëtarët të arrijnë mbështetjen te vetja, sidoqoftë, nëse presidenti i kunjit dhe peshkopët nuk i rrotullojnë çelësat që të ndezin motorin e të drejtojnë autobusin, askush nuk shkon askund.”

RONALD ABAN, përgjegjësi i Shërbimeve për Mbështetjen te Vetja në Takloban, Filipine.

PËRGJEGJËSITË E UDHËHEQËSIT TË PRIFTËRISË

Presidenca e Kunjit (ose Presidenca e Distriktit)

1. Mësojuni anëtarëve të lagjes doktrinat e mbështetjes te vetja (shih kopertinën e pasme). Udhëzoni peshkopët dhe anëtarët e komitetit të kunjit për mbështetjen te vetja në përgjegjësitë e tyre mbi mbështetjen te vetja.
2. Përcaktoni objektivat e mbështetjes te vetja për kunjin.
3. Organizoni një komitet për mbështetjen te vetja që mund të hartojë, vëre në praktikë e vëzhgojë një plan veprimi të mbështetjes te vetja për kunjin.
4. Vendoseni si përparësi t'i ftoni misionarët e kthyer dhe të sapokthyerit në besim (sipas nevojës) që të marrin pjesë në veprimtari të mbështetjes te vetja.
5. Përfshijeni mbështetjen te vetja në rendin e ditës së këshillit të kunjit.
6. Jepini thirrje një specialisti në kunj për mbështetjen te vetja.
7. Thirrni misionarë me shërbim në Kishë sipas nevojës.
8. Rishikoni dhe veproni mbi bazën e raporteve të kunjit mbi përparimin e mbështetjes te vetja dhe të raporteve mbi huamarrjen nga Fondi i Qarkullueshëm Arsimor (FQA).
9. Jepini udhëzime qendrës së historisë familjare që të shpërndahen për qëllime të mbështetjes te vetja kur nevojiten.

Komiteti i Kunjit për Mbështetjen te Vetja

Komiteti i kunjit për mbështetjen te vetja përfshin individët vijues: një këshilltar të presidencës së kunjit (kryetar), këshilltarin e lartë të caktuar për mbështetjen te vetja, një anëtare të presidencës së Shoqatës së Ndihmës, kryetarin e këshillit të peshkopëve për mirëqenien dhe specialistin e kunjit për mbështetjen te vetja. Pjesëmarrës të mundshëm mund të përfshijnë anëtarë të presidencave të Të Rinjve dhe Të Rejave, specialistë të tjerë të kunjit, misionarë të moshuar kohëplotë dhe misionarë me shërbim në Kishë.

1. Shikoni "Laboring unto Self-Reliance" [Të Punuarit për Mbështetjen te Vetja] (e gjendur në srs.lds.org/videos).
2. Hartoni, zbatoni dhe vëzhgojeni një plan veprimi të mbështetjes te vetja për kunjin.
3. Ofroni rregullisht mbledhje shpirtërore *Shtegu Im drejt Mbështetjes te Vetja* (shih faqen 4).
4. Organizoni dhe plotësoni me njerëz në kunj një qendër për mbështetjen te vetja. Caktoni një çift misionarësh me shërbim në Kishë ose një specialist të mbështetjes te vetja që të drejtojë veprimet e qendrës dhe të organizojë grupe të mbështetjes te vetja (shih faqen 2).
5. Mësojuni këshillave të lagjeve detyrat e tyre mbi mbështetjen te vetja.
6. Përdorini burimet dhe shërbimet e krijuara nga punonjësit e Mbështetjes te Vetja.
7. Vendoseni si përparësi t'i ftoni misionarët e kthyer dhe të sapokthyerit në besim (sipas nevojës) që të marrin pjesë në mbledhjet shpirtërore *Shtegu Im* dhe t'u bashkohen grupeve të mbështetjes te vetja.



"Mbështetja te vetja është fryt i punës sonë dhe është bazë për të gjitha praktikat e tjera të mirëqenies. . . . 'Le të punojmë për atë që na duhet. Le të jemi të mbështetur te vetja dhe të pavarur. Shpëtimi nuk mund të sigurohet me ndonjë parim tjetër.'"

THOMAS S. MONSON
(citon Marion G. Romney), "Guiding Principles of Personal and Family Welfare", *Ensign*, shtator 1986, f. 3

Specialisti i Kunjit për Mbështetjen te Vetja

Specialisti shërben si hallkë lidhëse për të gjitha funksionet e Shërbimeve për Mbështetjen te Vetja (komiteti i mbështetjes te vetja, qendra e kunjit për mbështetjen te vetja dhe përgjegjësi i Shërbimeve për Mbështetjen te Vetja).

1. Përgatiteni rendin e ditës të komitetit të kunjit për mbështetjen te vetja.
2. Trajtoni misionarë dhe vullnetarë në shërbim të Kishës që të mbajnë në punë një qendër burimore për mbështetjen te vetja.
3. Trajtoni dhe mbikëqyrni specialistë të tjerë për mbështetjen te vetja në kunj.
4. Porositni materiale të mbështetjes te vetja sipas nevojës.
5. Trajtojini dhe ndihmojini peshkopët dhe këshillat e lagjes kur kërkohet.
6. Ndhimjojini anëtarët të regjistruhen te srs.lds.org/register.
7. Organizoni, vëzhgoni, mbështetni dhe ndihmoni grupe të mbështetjes te vetja. (Mund t'u kërkohet anëtarëve të tjerë që t'i ndërmjetësojnë grupet sipas nevojës.)
8. Studiojini dhe ndiqini parimet që gjenden në internet te srs.lds.org/facilitator.


Peshkopata (ose Presidenca e Degës)

1. Mësojuni anëtarëve të lagjes doktrinën e mbështetjes te vetja (shih kopertinën e pasme).
2. Drejtojini përpjekjet e mbështetjes te vetja nëpërmjet këshillit të lagjes:
 - Shquajini, numërojini dhe ftojini të gjithë anëtarët në nevojë që të bëhen të mbështetur te vetja. Mjeti i të Rriturve për Mbështetjen te Vetja në leader.lds.org/self-reliance mund të jetë i dobishëm për këtë proces.
 - Nëpërmjet udhëheqësve të kuorumit dhe të organizatave ndihmëse, jepni mbështetje, këshilltarë dhe ndihmë për ata që janë në nevojë.
3. Ftojini ata në nevojë të plotësojnë broshurën *Shtegu Im drejt Mbështetjes te Vetja* dhe t'i bashkohen një grupi për mbështetjen te vetja.
4. Ftoni specialistë të lagjes të mbështetjes te vetja që të ndihmojnë grupe sipas nevojës.
5. Drejtoni intervista miratimi të huamarrjes nga FQA-ja (shih srs.lds.org/loans).
6. Rishikoni dhe veproni mbi bazën e raporteve të kunjit mbi përparimin e mbështetjes te vetja dhe raportet e huamarrjes nga FQA-ja. Peshkopët nuk duhet të përfshihen në grumbullimin e huave nga FQA-ja.
7. Kërkoni ndihmë shtesë nga komiteti i kunjit për mbështetjen te vetja kur nevojitet.

BURIMET

Qendrat Burimore për Mbështetjen te Vetja

Kunjet nxiten të krijojnë qendra burimore për mbështetjen te vetja në një ndërtesë të Kishës, shpesh duke ndarë një vendndodhje me qendrën e historisë familjare. Qendrat burimore të mbështetjes te vetja plotësohen me njerëz nga misionarë dhe vullnetarë dhe japin qasje në internet, këshillim dhe burime të tjera të fuqishme për punëkërkuarët, të vetëpunësuarit dhe studentët e ardhshëm.



"Nuk ka nevojë për organizatë të re që të kujdeset për nevojat e këtij populli. Gjithçka nevojitet është të vihet priftëria e Perëndisë të punojë."

HAROLD B. LEE, "Admonitions for the Priesthood of God", *Ensign*, janar 1973, f. 104



"Nuk ka problem në familje, lagje apo kunj që nuk mund të zgjidhet nëse kërkohet për zgjidhje sipas mënyrës së Zotit duke u këshilluar – duke u këshilluar vërtet – me njëri-tjetrin."

M. RUSSELL BALLARD, *Counseling with Our Councils*, botim i rishikuar (2012), f. 4

Grupet për Mbështetjen te Vetja

Mbledhja e një grupi për mbështetjen te vetja përdor një model këshilli dhe është ndryshe nga shumica e orëve mësimore, mësimëve dhe seminareve praktike në Kishë. Nuk ka mësues apo trajnues. Në vend të tyre, anëtarët e grupit këshillohen së bashku, mësojnë së bashku, zotohen për të vepruar mbi atë që po mësojnë dhe mbajnë njëri-tjetrin përgjegjës për zotimet. Ky proces udhëheqjeje dhe këshillimi në grup, së bashku me fletoret e punës dhe materialet filmike, krijon një mjedis mësimi gjallërues që e forcon secilin anëtar në përparimin e vet drejt një jete të mbështetur te vetja.

Udhëheqësit e kunjit apo të lagjes thërrasin specialistë të mbështetjes te vetja për t'i organizuar dhe ndihmuar grupet e mbështetjes te vetja. Ndërmjetësit e grupit nuk janë mësues; përkundrazi ata e ndihmojnë grupin të zbatojë procesin e mbështetjes te vetja sikurse përvijohet në manuale. Ndërmjetëve do t'u nevojitet me raste hyrje në internet dhe një mënyrë për të shfaqur materiale filmike në mbledhjet e grupit. Udhëheqësit mund të formojnë grupe dhe të thërrasin specialistë në sasinë që do t'u nevojitet. Mund t'u kërkohet anëtarëve të grupit që t'i ndërmjetësojnë grupet sipas nevojës. Çdo grup mblidhet të paktën 12 herë për dy orë çdo seancë dhe përbëhet nga 8 deri në 14 anëtarë. Grupet mund të mblidhen në qendrat burimore të mbështetjes te vetja në kunj, në ndërtesa të Kishës ose në vende të tjera të përshtatshme të volitshme për anëtarët.

Udhëheqësit vendorë përcaktojnë se cili nga grupet vijuese nevojitet në njësitë e tyre.

1. Grupet *Nisja dhe Rritja e Biznesit Tim* i ndihmojnë njerëzit të fillojnë ose të përmirësojnë biznesin e vet. Këto grupe e zëvendësojnë Seminarin Praktik të Vetëpunësimit.
2. Grupet *Kërkimi Im për Vend Pune* i ndihmojnë njerëzit të gjejnë një punë të re ose më të mirë. Këto grupe e zëvendësojnë Seminarin Praktik të Karrierës.
3. Grupet *Arsimimi për Punë më të Mirë* i ndihmojnë njerëzit të gjejnë një udhë arsimimi për të rritur të ardhurat e tyre. Këto grupe zëvendësojnë Planifikimin për Sukses.

Si pjesë e secilit grup, anëtarët studiojnë gjithashtu 12 tema doktrimore mbi mbështetjen te vetja nga broshura *Themeli im: Parimet, Aftësitë, Zakonet*.

Përkrahja e Punonjësit të Kishës dhe Lista e Parapëlqyer e Burimeve

Kisha punëson njerëz në çdo fushë për të ndihmuar përpjekjen për mbështetje te vetja. Këta përfshijnë një përgjegjës zonal për mbështetjen te vetja (MZMV), një përgjegjës veprimesh të mbështetjes te vetja, përgjegjës të Shërbimeve për Mbështetjen te Vetja dhe pjesëtarë të tjerë të trupës organizative. Këta të punësuar ndihmojnë të bashkërendohen nevojat e qendrave burimore të kunjëve për mbështetjen te vetja dhe u sigurojnë kunjëve burime dhe trajnim. Këto burime përfshijnë këshilltarë, lista Programesh dhe Shkollash të Parapëlqyera, mundësi vendore punësimi dhe emra organizatash që financojnë kapital për të filluar biznese.

Faqja e Internetit për Mbështetjen te Vetja

Më shumë informacion për udhëheqësit dhe anëtarët gjendet në internet te srs.lds.org.

Si mund ta mat përparimin e mbështetjes te vetja të anëtarëve në lagjen apo kunjin tim?

Ndërsa e ndihmoni lagjen ose kunjin tuaj të përparojë drejt mbështetjes te vetja, merreni parasysh të matni herë pas here numrin e anëtarëve që:

1. *Shquhen nga peshkopët si jo të mbështetur te vetja.*
2. *E kanë plotësuar programin Shtegu Im.*
3. *E kanë plotësuar programin Themeli Im.*
4. *Kanë nisur një biznes, një punë të mirë ose një program arsimor.*

Burimet e Udhëheqësit dhe Nëpunësit

Mjeti i të Rriturve për Mbështetjen te Vetja mund t'i përkrahë peshkopët ndërsa ata i shquajnë dhe përqendrohen tek anëtarët të cilëve u mungojnë domosdoshmëritë e jetës. Te ky burim mund të hyhet në leader.lds.org/self-reliance.

Mbledhjet Shpirtërore Shtegu Im drejt Mbështetjes te Vetja

Kunjet apo lagjet mbajnë rregullisht mbledhje shpirtërore *Shtegu Im drejt Mbështetjes te Vetja*. Kjo mbledhje shpirtërore i fut anëtarët në shtegun e mbështetjes te vetja duke i ndihmuar të kuptojnë rëndësinë doktrinale të mbështetjes te vetja, të vlerësojnë nivelin e tyre aktual të mbështetjes te vetja, të përcaktojnë aftësitë dhe të ardhurat që nevojiten për t'u bërë përkohësisht i mbështetur te vetja dhe të përzgjedhin grupin e mbështetjes te vetja që do t'i ndihmojë ata ta arrijnë atë synim. Broshura *Shtegu Im drejt Mbështetjes te Vetja* e lehtëson këtë proces. Vlerësimi mund të bëhet gjithashtu individualisht, me një udhëheqës të priftërisë, me një specialist të mbështetjes te vetja, në një qendër burimore të mbështetjes te vetja ose në mjedise të tjera. Shikoni "How to Use My Path" [Si ta Përdor Shtegun Tim"] në srs.lds.org/videos.

Materiale Filmike për Trajnim

Shihini materialet filmike vijuese në internet te srs.lds.org/videos.

PUBLIKU	TITULLI I MATERIALIT FILMIK	
Udhëheqësit	Unë Do Të Siguroj për Shenjtorët e Mi	
	Komiteti i Kunjtit për Mbështetjen te Vetja	
	Mbledhja e Komitetit të Kunjtit për Mbështetjen te Vetja	
	Specialistët e Kunjtit për Mbështetjen te Vetja	
	Ndihma për Këshillat e Lagjeve	
	Si të Formojmë Grupe të Mbështetjes te Vetja	
	Të Punuarit për Mbështetjen te Vetja	
	materialet filmike të programit <i>Themeli Im</i> (12)	
	Ndërmjetësit e Grupit	Qëllimi Im
		Si të Ndërmjetësoj një Grup
Si të: Përgatituni		
Si të Udhëheq Programin Themeli Im		
Si të Udhëheq Pjesën: Raportoni		
Si të Udhëheq Pjesën: Mësoni		
Si të Udhëheq Pjesën: Përsiatni		
Si të Udhëheq Pjesën: Zotohuni		
Si t'i: Administroj Mbledhjet		
Të Mësuarit e "Shko dhe Bëj"		

Mirëpritja e Përshtypjeve

Ju lutemi, dërgojini idetë, përshtypjet, sugjerimet dhe përvojat tuaja te [SRS-feedback@ldschurch.org](mailto:feedback@ldschurch.org) ose srs.lds.org/feedback.

Materialet e Grupit

Materialet, materialet filmike dhe trajnimi gjenden në programin celular Biblioteka e Ungjillit dhe në internet te srs.lds.org. Materialet mund të porositen gjithashtu nga qendrat e Kishës për shpërndarjen.



Shtegu Im drejt Mbështetjes te Vetja

Të gjithë pjesëmarrësit fillojnë me këtë broshurë për të përcaktuar nivelin e tyre aktual të mbështetjes te vetja e për të vendosur se cili grup do t'i ndihmojë të bëhen të mbështetur te vetja. Grupet përfshijnë vetëpunësim, kërkim për vend pune dhe arsimim.



Themeli Im: Parimet, Aftësitë, Zakonet

Anëtarët e të tre grupeve e përdorin këtë broshurë ndërsa i diskutojnë dhe i zbatojnë parimet thelbësore shpirtërore të mbështetjes te vetja.



Nisja dhe Rritja e Biznesit Tim

Për ata që e kanë një biznes ose dëshirojnë ta nisin një. Anëtarët e grupit ushtrojnë mbajtjen e dokumenteve, tregtimin dhe administrimin e parave në dorë. Ata gjithashtu vënë në provë mënyra për t'i shtuar të ardhurat e tyre nëpërmjet eksperimenteve të biznesit të vogël.



Kërkimi Im për Vend Pune

Për ata që i kanë aftësitë për të gjetur një vend të mirë pune. Anëtarët e grupit gjejnë një punë duke i shquar mundësitë, duke punuar në rrjet, duke e paraqitur veten e tyre fuqishëm dhe duke u përgatitur për pyetjet e intervistës. Pjesëmarrja në këtë grup sjell si rrjedhojë gjetjen e një vendi pune.



Arsimim për Punë më të Mirë

Për ata të cilëve u nevojitet arsimim ose trajnim që të gjejnë një vend të mirë pune ose që të nisin një biznes. Anëtarët e grupit e shquajnë punën që do t'i ndihmojë ata të bëhen të mbështetur te vetja dhe më pas gjejnë një shkollë ose program (përfshirë Pathway-n) që i çon drejt asaj pune. Pjesëmarrja në këtë grup sjell si rrjedhojë një plan shkollor dhe huamarrje nga FQA-ja (nëse nevojitet).

Anëtarët e grupit që i plotësojnë kërkesat te *Themeli Im* dhe *Nisja dhe Rritja e Biznesit Tim* mund të jenë të përshtatshëm për të marrë certifikata nga Kolegji i Biznesit i SHDM.

DOKTRINAT DHE PARIMET E MBËSHTETJES TE VETJA

Doktrinat

1. Materialja dhe shpirtërorja janë një

Doktrina e Besëlidhje 29:34; Alma 37:38-43

2. Zoti na urdhëron që të jemi të mbështetur te vetja dhe e ka të gjithë fuqinë për të na ndihmuar

Doktrina e Besëlidhje 104:15-16; 100:1; 1 Nefi 9:6; 2 Nefi 27:21, 23; Mosia 4:9; Mateu 28:18

3. Mbështetja te vetja është një parim ekzaltimi

Doktrina e Besëlidhje 132:20

Parimet

Për hollësi të tjera mbi parimet vijuese, drejtohuni te broshura e mbështetjes te vetja *Themeli Im: Parimet, Aftësitë, Zakonet*.

1. Ushtroni Besim te Jezu Krishti

1 Nefi 9:6; Hebrenjve 11

2. Jini të bindur

Doktrina e Besëlidhje 93:28; 130:20-21; Abraham 3:25; Hebrenjve 5:8-9

3. Veproni

2 Nefi 2:16, 26

4. Shërbeni dhe bëhuni një

Moisiu 7:18; Galatasve 5:14